# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6887
E premte, 5 maj 2023
Çmimi 0.40

## Zelensky në Hagë thotë se Putini duhet të përballet me drejtësinë

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

GRUPI PËR STUDIME JURIDIKE DHE POLITIKE (GLPS) MBAN TRYEZËN E DISKUTIMIT ME TEMËN "NJË ADMINISTRATË PUBLIKE E VARUR NGA USHTRUESIT E DETYRËS: CILAT JANË PASOJAT DHE ZGJIDHJET PËR TË ZBUTUR RREZIQET?" FAQE 4-5

# SHQETËSUESE, 11 MINISTRI FUNKSIONOJNË ME USHTRUES DETYRE TË SEKRETARIT



Drejtoresha ekzekutive në GLPS, Arbëresha Loxha-Stublla, ka thënë se situata me ushtrues detyre është bërë një fenomen i rregullt në administratën publike të Kosovës. Ajo ka thënë se prej 15 ministrive sa i ka qeveria aktuale, vetëm katër prej tyre kanë sekretar me mandat të plotë e 11 të tjera funksionojnë me ushtrues detyre. Ajo ka theksuar se edhe zyra e kryeministrit nuk ka sekretar me mandat të plotë. Edhe nga Zyra e BE-së në Kosovë kanë theksuar se për vite me radhë kanë qenë të shqetësuar sa i përket rritjes së numrit të ushtruesve të detyrës

## BE-ja: ROLI I EKIPIT MENAXHUES PËRFUNDON VETËM KUR TË MIRATOHET STATUTI

FAQE 5



## VEPRIMTARI SALI BISLIMI FTOHET NË DREKË NË PARLAMENTIN ZVICERAN, DISKUTOHET PËR KOSOVËN DHE SPECIALEN



FAQE 7

## AKTUALE



### AKTAKUZË NDAJ TRI TË PANDEHURAVE PËR SULMIN NDAJ TË MOSHUARËS NË STREHIMOREN "ORENDA" NË PEJË F. 6

### KOSOVA DHE KROACIA ARRIJNË MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E MBROJTJES F. 3

### CERTIFIKOHET REZULTATI PËR KUVENDIN KOMUNAL NË LEPOSAVIQ, TRI ULËSE MBESIN TË ZBRAZËTA F. 7

## EKONOMI



### ATK-ja DHE DEPARTAMENTI PËR TATIMIN NË PRONË NËNSHKRUAJNË MEMORANDUM BASHKËPUNIMI F. 3

### ODA AMERIKANE: RREGULLIMI I ÇMIMIT TË BARNAVE, NJË HAP PËRPARA DREJT SHËRBIMEVE CILËSORE SHËNDETËSORE F. 8

## SPORT



### BALLKANI BARAZON NDAJ PRISHTINËS, PËRFITON DRITA F. 10

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

# HRW dënon luftimet në zonat e banuara në Sudan

**Nju-Jork, 4 maj** - Organizata Human Rights Watch (HRW) ka dënuar përdorimin e armëve të rënda në zonat e banuara dhe me popullsi të dendur në Sudan. "Ushtritë ndërluftuese të Sudanit po tregojnë shpërfillje të pamatur për jetët e civilëve duke përdorur armë të pasakta në zonat e populluara urbane", tha Mohamed Osman, ekspert sudanez për të drejtat e njeriut, thuhet në një raport të HRW-së.
Organizata i bëri thirrje Këshillit të Sigurimit të OKB-së që të bëjë më shumë për ta garantuar sigurinë e popullatës dhe për t'i mbajtur përgjegjës palët ndërluftuese për konfliktin. Sipas kësaj organizate, dëshmitarët okularë në Khartoum raportuan se armët kundërajrore ishin vendosur dhe se me to ishte qëlluar menjëherë në afërsi të Ushtarëve të Forcave të Mbështetjes së Shpejtë Paraushtarake (RSF), të cilat janë në luftë për pushtet me ushtrinë zyrtare.
Ata, gjithashtu, kërkuan strehim prapa shtëpive nga bombardimet e ushtrisë, duke i bërë ndërtesat objektiva, raporton agjencia gjermane e lajmeve DPA.
Shumë civilë në Khartoum, por edhe në pjesë të tjera të vendit, janë detyruar të qëndrojnë në shtëpi që nga shpërthimi i luftimeve më 15 prill.



Në vapën e madhe kanë vetëm një furnizim të kufizuar me ujë dhe energji elektrike, po ashtu telashe me kujdesin mjekësor, thuhet në raport.
Temperaturat në Khartoum aktualisht po rriten mbi 40 gradë celsius.
Që nga grusht-shteti i vitit 2021, Sudani është udhëhequr nga këshilli i gjeneralëve në krye me dy ushtarakët që aktualisht po luftojnë: gjenerali Abdel Fattah al-Burhan, që është kreu i Forcave të Armatosura dhe presidenti i shtetit, dhe zëvendësi i tij, gjenerali Mohamed Hamdan Dagalo, që udhëheq Forcat e Mbështetjes së Shpejtë.
Dy gjeneralët kanë mospajtime lidhur me mënyrën se si shteti do të shkojë drejt sundimit civil.
Të paktën 334 000 mijë njerëz janë zhvendosur brenda vendit në Sudan që nga shpërthimi i luftimeve për kontrollin e vendit në mes të prillit, sipas Kombeve të Bashkuara.

# Zelensky në Hagë thotë se Putini duhet të përballet me drejtësinë

**Hagë, 4 maj** - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky mbërriti në Holandë të mërkurën vonë për një udhëtim të paparalajmëruar më parë. Ai arriti në aeroportin e Amsterdamit me një aeroplan të qeverisë holandeze që vinte nga Helsinki dhe më pas u drejtua në një autokolonë drejt Hagës nën shoqërimin e policisë.
Ligjvënësit holandezë konfirmuan në "Twitter" se një takim me presidentin ukrainas ishte planifikuar në Hagë të enjten.
Mediet holandeze raportuan se ai do të takohet edhe me kryeministrin e Holandës, Mark Rutte, dhe do të mbajë një fjalim



në Hagë.
Ai vizitoi Gjykatën Penale Ndërkombëtare, ku tha se duhet të krijohet një gjykatë e posaçme për të kërkuar llogari nga Rusia për "krimet e saj". "Duhet të ketë përgjegjësi për këto krime. Dhe kjo mund të zbatohet vetëm nga gjykata", u tha ai diplomatëve dhe zyrtarëve në Gjykatën Penale Ndërkombëtare në Hagë. "Ne të gjithë duam të shohim një Vladimir (Putin) tjetër këtu në Hagë, atë që meriton të sanksionohet për veprimet e tij kriminale këtu, në kryeqytetin e së drejtës ndërkombëtare", tha Zelensky në një fjalim. "Jam i sigurt se kjo do të ndodhë kur të fitojmë dhe ne do të fitojmë", tha ai.
Kjo gjykatë e mbështetur nga OKB-ja ka nisur hetimet për krimet e mundshme të luftës të kryera nga Rusia dhe në mars lëshoi një urdhër-arrest ndërkombëtar për presidentin rus Vladimir Putin.
Vizita e presidentit ukrainas Zelensky nuk u njoftua paraprakisht dhe shënon vizitën e parë të liderit ukrainas në Holandë.
Më parë ai ishte takuar me liderët nordikë në një samit në Finlandë, në të cilin ata premtuan mbështetjen e tyre për liderin ukrainas për aq kohë sa të ishte e nevojshme.
Holanda deri tani i ka ofruar Ukrainës ndihmë ushtarake rreth 1.2 miliard euro duke e ndihmuar Ukrainën që të mbrohet kundër pushtimit të plotë të Rusisë.
Rusia nisi pushtimin e Ukrainës në muajin shkurt të vitit të kaluar.

# ShBA-ja rrit normat e interesit në vlerën më të lartë që 16 vjet

**Uashington, 4 maj** - Banka Qendrore e ShBA-së ka rritur normat e interesit në nivelin më të lartë në 16 vjetët e fundit, në tentim për t'i stabilizuar çmimet.
Rezerva Federale rriti normën bazë të interesit për 0.25 për qind - rritja e dhjetë në 14 muajt e fundit.
Këto vendime i kanë rritur ndjeshëm kostot e huamarrjes në të gjithë vendin me ekonominë më të fuqishme në botë, duke shkaktuar ngecje në disa sektorë, si ai banesor, dhe çoi drejt falimentimit të fundit të tri bankave amerikane.
Rezerva Federale paralajmëroi se kjo rritje e normave të interesit mund të jetë e fundit.
Banka Qendrore e ShBA-së filloi t'i rrisë në mënyrë të ndjeshme normat e interesit vitin e kaluar kur çmimet në ShBA po rriteshin me ritmin më të shpejtë në dekada.
Këto vendime e kanë shtyrë cakun për normën standarde të interesit në 5 deri në 5.25 për qind, për dallim prej afër zeros sa kishte qenë në mars të vitit 2022.
Bankat qendrore në mbarë botën, përfshirë ato në Evropë, kanë ndërmarrë veprime të ngjashme.
Normat më të larta të interesit e bëjnë më të shtrenjtë blerjen e një shtëpie, huamarrjen për të zgjeruar një biznes ose për të marrë borxhe të tjera. Duke rritur këto kosto, zyrtarët presin që kërkesa të bjerë dhe çmimet të stabilizohen.
Që kur Rezerva Federale filloi fushatën e saj, rritjet e çmimeve në ShBA kanë treguar shenja stabilizimi.
Në mars, inflacioni, norma me të cilën rriten çmimet, qëndroi në 5 për qind - niveli më i ulët në gati dy vjet - megjithëse ende në nivel të pakënaqshëm për Rezervën Federale, i cili synon një vlerë prej 2-përqindësh.



## Kushtetuesja e Francës refuzon kërkesën për referendum lidhur me reformën për pensione

**Paris, 4 maj** - Organi më i lartë kushtetues i Francës e hodhi poshtë më 5 maj tentimin e fundit të opozitës për ta zhbërë reformën e presidentit francez Emmanuel Macron për ta rritur moshën e pensionimit në 64 vjeç. Kushtetuesja tha se kërkesa për referendum nuk i plotësonte kriteret e nevojshme.
Kjo është hera e dytë që Këshilli Kushtetues hedh poshtë planin për ta rikthyer moshën e pensionimit në 62 vjeç nëpërmjet një referendumi të mundshëm ose një projektligji të ri. Nëse do të ishte aprovuar kërkesa, procesi do të ishte i gjatë dhe nuk do ta ndalte hyrjen në fuqi të ligjit të Macronit.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

## Bedri Halimi shpallet i pafajshëm nga akuzat për korrupsion



PRISHTINË, 4 MAJ - Kryeinspektori i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Bedri Halimi, është shpallur i pafajshëm nga akuzat për korrupsion, në rastin e njohur si "Brezovica". Kjo pasi Gjykata e Apelit e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Lajmin e ka bërë me dije vetë Halimi përmes një postimi në "Facebook". "Gjykata e Apelit, e ka vërtetuar Aktgjykimin e shkallës së parë, të Gjykatës Speciale, për pafajësinë time, në rastin e Prevallës", ka shkruar Halimi. "Gjykata e Apelit e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë, të Gjykatës Speciale, për pafajësinë time, në rastin e Prevallës", ka shkruar Halimi.

# Kosova dhe Kroacia arrijnë marrëveshje bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes

PRISHTINË, 4 MAJ - Me rastin e pjesëmarrjes në ekspozitën dhe konferencën e ASDA (Adriatic Sea Defense & Aerospace), ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka takuar homologun e tij kroat, Mario Banozic, me të cilin ka nënshkruar marrëveshje kornizë për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes.

Në këtë takim të dy ministrat diskutuan për shumë çështje relevante për situatën aktuale gjeopolitike, duke përfshirë ndikimin rus në Ballkan, domosdoshmërinë e unitetit përballë tendencës për destabilizim dhe cenim të vlerave demokratike, investimin e përbashkët në fusha strategjike sa i përket sigurisë dhe mbrojtjes, me qëllim garantimin e paqes dhe stabilitetit në rajon dhe më gjerë.

Gjithashtu, ministri Mehaj i ka theksuar ministrit Banozic faktin se Kosova është falënderuese për mbështetjen e deritanishme nga ana e shtetit kroat dhe se përkushtimi do të jetë i fuqishëm për bashkëpunim të mëtutjeshëm, ofrim të trajnimeve në fushën e kërkim-shpëtimit si dhe të çminimit.

Nga ana tjetër, ministri kroat i Mbrojtjes shprehu vlerësimin e tij për hapat e ndërmarrë nga ana e Kosovës për zhvillimin e ushtrisë, po ashtu faktin e ngritjes së kapaciteteve ushtarake përmes blerjeve direkte, shtet më shtet, në përputhje me standardet e NATO-s.

Ndër të tjera, ministri Banozic garantoi mbështetje të pakursyer nga ana e Kroacisë për Kosovën dhe të ardhmen tonë evropiane.




# Memorandum bashkëpunimi në mes të ATK-së dhe Departamenti për Tatimin në Pronë



PRISHTINË, 4 MAJ - Drejtori ekzekutiv i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, dhe Enis Spahiu, zëvendëssekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi, i cili ka për qëllim rritjen e shkëmbimit të informatave lidhur me zbulimin dhe parandalimin e evazionit tatimor, si dhe për ngritjen dhe lehtësimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit ndërinstitucional. "Bazuar në përgjegjësitë e memorandumit, Departamenti i Tatimit në Pronë do t'i sigurojë qasje për lexim dhe printim të informatave në bazën e të dhënave të regjistrave të tatimit në pronë për zyrtarët e autorizuar nga ATK, bazuar në Ligjin nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe Ligjin 03/L 222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat", ka njoftuar ATK-ja.

ATK-ja do t'i caktojë zyrtarët e autorizuar, detyrat e të cilëve kërkojnë të kenë qasje në bazat e të dhënave të regjistrave të tatimit në pronë, përmes uebit dhe do të kërkojë me shkrim nga DPT krijimin e llogarive të koduara të përdoruesve për zyrtarët e autorizuar nga ATK.

Finalizimi i këtij memorandumi është bërë me qëllimin e vetëm - për parandalimin, zbulimin e evazionit tatimor dhe për qëllime të tatimit në pronën e paluajtshme.

## Largohet nga puna një zyrtar korrektues në Dubravë, dyshohet për ryshfet



PRISHTINË, 4 MAJ - Shërbimi Korrektues i Kosovës ka njoftuar të enjten se ka larguar nga puna zyrtarin me inicialet Sh. G., Mbikëqyrës në Qendrën Korrektuese të Dubravës. Sipas njoftimit, gjatë kryerjes së detyrës ai e ka kryer veprën penale "keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe marrje të ryshfetit".

ShKK-ja ka bërë me dije se vendimi për largim nga puna është marrë nga Komisioni Disiplinor. "Shërbimi Korrektues i Kosovës mbetet i përkushtuar për luftimin e këtyre dukurive negative dhe do t'i ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore ndaj secilit individ, i cili është i përfshirë në veprime të tilla korruptive, pavarësisht rolit dhe funksionit që ka", thuhet në komunikatën për medie të ShKK-së.



GRUPI PËR STUDIME JURIDIKE DHE POLITIKE (GLPS) MBAN TRYEZËN E DISKUTIMIT ME TEMËN "NJË ADMINISTRATË PUBLIKE E VARUR NGA USHTRUESIT E DETYRËS: CILAT JANË PASOJAT DHE ZGJIDHJET PËR TË ZBUTUR RREZIQET?"

# Shqetësuese, 11 ministri funksionojnë me ushtrues detyre të sekretarit

Drejtoresha ekzekutive në GLPS, Arbëresha Loxha-Stublla, ka thënë se situata me ushtrues detyre është bërë një fenomen i rregullt në administratën publike të Kosovës. Ajo ka thënë se prej 15 ministrive sa i ka qeveria aktuale, vetëm katër prej tyre kanë sekretar me mandat të plotë e 11 të tjera funksionojnë me ushtrues detyre. Ajo ka theksuar se edhe zyra e kryeministrit nuk ka sekretar me mandat të plotë. Edhe nga Zyra e BE-së në Kosovë kanë theksuar se për vite me radhë kanë qenë të shqetësuar sa i përket rritjes së numrit të ushtruesve të detyrës

EPOKA E RE **Mal QORRAJ**

**Prishtinë, 4 maj** - Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka mbajtur tryezën e diskutimit me temën "Një administratë publike e varur nga ushtruesit e detyrës: cilat janë pasojat dhe zgjidhjet për të zbutur rreziqet?".
Arbëresha Loxha-Stublla, drejtoreshë ekzekutive në GLPS, ka thënë se situata me ushtrues detyre është bërë një fenomen i rregullt në administratën publike të Kosovës. Ajo ka thënë se prej 15 ministrive sa i ka qeveria aktuale, vetëm katër prej tyre kanë sekretar me mandat të plotë e 11 të tjera funksionojnë me ushtrues detyre.
Loxha-Stublla ka theksuar se edhe zyra e kryeministrit nuk ka sekretar me mandat të plotë. "Ne kemi parë që fenomeni i mosplotësimit të pozitave është bërë një rregull në administratën publike. Kjo situatë është shfrytëzuar nga të gjitha qeveritë dhe nga viti 2020 është bërë një fenomen shqetësuese. Një numër i madh i pozitave të larta mbahen me ushtrues detyre në Kosovë. Kjo natyrisht e vë në pikëpyetje edhe zbatimin e ligjit për zyrtarët publikë. Nga 15 ministri sa ka gjithsej Qeveria e Kosovës, vetëm katër ministri kanë sekretar me mandat të plotë, të tjerat funksionojnë me ushtrues detyre. Edhe vetë zyra e kryeministrit nuk ka sekretar me mandat të plotë. Është bërë një lloj fenomeni, që edhe pse proceduarat janë në rregull, personat nuk zgjedhen", ka deklaruar Loxha-Stublla.
Naser Shamolli, hulumtues i lartë në GLPS, i cili e ka paraqitur këtë analizë, ka theksuar se ky fenomen është duke ndodhur për shkak të ndryshimeve të ligjeve. Sipas tij, kjo dukuri filloj të shprehet më shumë në vitin 2011. Ai shtoi se duhet të parandalohen menjëherë marrëdhëniet e punës për ushtrues detyre. "Ky fenomen ka ndodhur që disa vjet dhe është fenomen që ka prekur shtetet fqinje dhe shtetet e BE-së. Deri në vitin 2010 kemi pasur një rregullore për shërbyes civilë, që nuk ka qenë dukuri e shprehur. Kjo dukuri filloi të shprehet më shumë në vitin 2011, kur kanë ndodhur disa ndryshime të ligjeve. Problematikë ka qenë afati që ka qenë tremujor. Kemi vetë deklarues që ka thënë se ka deri në shtatë vjet që ka pozitën ushtrues detyre. Elementi tjetër problematik është se këta ushtrues është dashur që të bëjnë zëvendësime", ka thënë Shamolli, duke shtuar se në vitin 2010 shumica e sekretarëve kanë qenë me ushtrues detyre, por që atëherë kanë qenë të ligjshme këto dispozita. "Më vonë, kur janë bërë këto dispozita, përfundimisht erdhëm në përfundim se Ligji për Zyrtarë Publikë ta ndalojë mundësinë që të rregullohen pozitat me ushtrues detyre. Sot kemi kaluar në procese të riorganizimit dhe kemi pozita të lira, pra kemi dukurinë e ushtruesit të detyrës. Periudha e ushtruesit të detyrës është gjashtë muaj me mundësi zgjedhjeje. Problemi i parë është afati. Mendoj se është e pamundshme të caktosh një afat të saktë i cili duhet të zbatohet në fund. Zgjedhja që bëhet te ligji i ri është problematike. Disa rekomandime janë që të zbatohet Ligji i Zyrtarëve Publikë dhe të ndërpritet menjëherë marrëdhënia e punës e ushtruesve të detyrës", ka thënë ai.
Bislim Bislimi, zëvendësdrejtor i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ka thënë se kjo formë po e vështirëson punën. Ai ka thënë se nuk e kupton faktin se pse zyrtarët e lartë nuk janë duke ndërmarrë hapa. "Unë kam vetëm dy muaj

# BE-ja: Roli i Ekipit Menaxhues përfundon vetëm kur të miratohet statuti

**Prishtinë, 4 maj** - Roli i Ekipit Menaxhues për statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë përfundon vetëm kur ai statut të miratohet prandaj, sipas Bashkimit Evropian, vendimi i Qeverisë së Kosovës për ta shkarkuar atë është në kundërshtim me marrëveshjen. Kështu ka thënë të enjten në një konferencë për shtyp në Bruksel zëdhënësi i Bashkimit Evropian për politikë të jashtme dhe siguri, Peter Stano, duke u përgjigjur në disa pyetje lidhur me rolin e Ekipit Menaxhues.

Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal në Qeverinë e Kosovës, Elbert Krasniqi, më 3 maj ka liruar nga detyra anëtarët e Ekipit Menaxhues. Ekipi në fjalë, i përbërë nga katër serbë nga Kosova, mori pjesë në takimin e fundit të dialogut në nivel të lartë, ku edhe paraqiti draftin e parë të statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, propozim i cili menjëherë u hodh poshtë nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Për më tepër, Kurti tha se koordinatorja e këtij ekipi, Danijella Vujiçiq, "është në konflikt interesi", sepse ajo ka dhënë betimin si deputete në Kuvendin e Republikës së Serbisë.

I pyetur se pjesë e cilit delegacion ishte Ekipi Menaxhues në takimin e fundit, Stano tha se ai ekip mori pjesë "si delegacion më vete" dhe se "ishin ftuar të vijnë dhe t'i bashkohen takimit për një pikë të rendit të ditës". "Ata nuk ishin pjesë e asnjërit delegacion, as i Serbisë e as i Kosovës", deklaroi Stano.

Zëdhënësi i BE-së tha se përbërja e këtij ekipi "është në përputhje me marrëveshjen e dialogut". "Palët ishin pajtuar rreth përbërjes së Ekipit Menaxhues. Anëtarët e Ekipit Menaxhues janë propozuar nga Serbia dhe zyrtarisht janë emëruar nga Kosova", sqaroi Stano. Sipas BE-së, tha Stano, "marrëveshjet e dialogut qartë thonë se ekipet menaxhuese duhet të ekzistojnë derisa të miratohet statuti i Asociacionit". "Ekipi Menaxhues propozoi dhe paraqiti draftin e parë, që do të thotë se nisën procesin e jo që procesi mori fund. Prandaj, vendimi për ta shkarkuar Ekipin Menaxhues shkel tekstin dhe frymën e marrëveshjes", theksoi Stano.

Pati edhe disa pyetje të gazetarëve rreth asaj se deri kur mund të vazhdohet në këtë mënyrë dialogu, me refuzime të njëpasnjëshme të palëve. "Jeta është e vështirë, e dialogu është edhe më i vështirë", u përgjigj zëdhënësi i BE-së duke përsëritur se arritja e marrëveshjes është e domosdoshme që palët të ecin para në procesin e integrimit evropian dhe se, në rast të dështimit, do të ketë pasoja, përfshirë edhe ato financiare.

Në pyetjen se a mund të thuhet se ekziston marrëveshja në tërësi, pasi presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka përsëritur se "ia ka bërë të qartë BE-së se nuk do t'i zbatojë të gjitha pikat e marrëveshjes", Stano ritheksoi se "Marrëveshja ekziston" dhe se "përfaqësuesi i lartë, Joseph Borrell, e ka bërë të qartë se Deklarata e lëshuar nga BE-ja është parë dhe është pranuar edhe nga presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, edhe nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe nga kjo buron edhe obligimi i palëve për ta zbatuar".

Ky zëdhënës i Bashkimit Evropian përmendi edhe Deklaratën për të Zhdukurit si dëshmi të progresit në dialog dhe shprehu bindjen e Bashkimit Evropian se palët do të punojnë për ta zbatuar këtë marrëveshje dhe për ta zbuluar fatin e personave të zhdukur gjatë luftës.

Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për formimin e Asociacionit në vitin 2013, ndërsa për parimet e tij janë pajtuar në vitin 2015.

Në vitin 2016 Ministria e atëhershme e Administrimit të Vetëqeverisjes Lokale në Kosovë ka emëruar Ekipin Menaxhues për hartimin e draft-statutit. Por, marrëveshja për Asociacion nuk është zbatuar kurrë për shkak të këmbënguljes së Beogradit që ai të ketë kompetenca të gjera. Prishtina i ka refuzuar ato, me arsyetimin se mund ta kërcënojnë funksionalitetin e shtetit.



që jam zgjedhur në këtë pozitë. Në momentin e marrjes së detyrës kam vërejtur mungesën e rekrutimeve. Me marrjen e kësaj detyre kam marrë disa procedura që janë duke u zhvilluar dhe shpresoj të kenë sukses. Numri i ushtruesve të detyrave ka rritur barrën dhe vështirësitë në anën tjetër", është shprehur Bislimi.

Mikaela Gronqvist, nga Zyra e BE-së në Kosovë, ka thënë se për vite me radhë kanë qenë të shqetësuar sa i përket rritjes së numrit të ushtruesve të detyrës. "Ne kemi mjaft njohuri dhe përcjellim reformat që ndërmerr qeveria sa i përket administratës publike. Për vite me radhë kemi qenë të shqetësuar me atë që e kemi parë me rritjen e numrit të ushtruesve të detyrës te nivelet e larta si dhe tek të tjerat. Sa iu përket ushtruesve të detyrës, nuk është se është bërë shumë nga qeveria për ta përmirësuar këtë situatë. Nuk ka emërime të personave pas konkursit, kjo është shqetësuese dhe do të ketë një numër të madhe të u.d-ve në administratën publike", ka thënë Gronqvist.

## Po vazhdon realizimi i projektit për shenjëzimin e rrugëve në Malishevë

**Malishevë, 4 maj** - Në kuadër të realizimit të projekteve, komuna e Malishevës po vazhdon realizimin e projektit për shenjëzimin e rrugëve dhe objekteve publike në tërë territorin e saj. Ky projekt është trevjeçar dhe në vazhdimësi do të bëhet shenjëzimi, sidomos në rrugë afër objekteve me rëndësi, siç janë shkollat, me qëllim të krijimit të sigurisë për nxënës, por edhe për parandalimin e aksidenteve të tjera në komunikacion. Këto ditë ky projekt është realizuar në disa vendbanime, ndërsa projekti do të vazhdojë të realizohet në të gjitha fshatrat dhe në qytetin e Malishevës. Projekti realizohet përmes Drejtorisë së Shërbimeve Publike në komunën e Malishevës dhe financohet nga buxheti i komunës.




# Aktakuzë ndaj tri të pandehurave për sulmin ndaj të moshuarës në strehimoren "Orenda" në Pejë

**Pejë, 4 maj** - Prokuroria Themelore në Pejë ka njoftuar se ka ngritur aktakuzë ndaj tre personave të pandehur, A. P., A. R., dhe R. K., për shkak të dyshimit të bazuar mirë se të njëjtat në bashkëkryerje, ndaj viktimës së ndjeshme (e moshuar), kanë kryer veprën penale "Sulmi", nga neni 184, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1, lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.
Sipas aktakuzë, tri të pandehurat në cilësinë e infermiereve në shtëpinë e kujdesit për të moshuar "Orenda", me dashje dhe në bashkëkryerje përdorin forcën ndaj të moshuarës, e cila ishte e vendosur në këtë strehimore, në atë mënyrë që pasi të pandehurat planifikojnë ta vënë nën kontroll viktimën e ndjeshme, me kërkesën e të pandehurës A. P., e pandehura R. K., e incizon me telefon, kurse e pandehura A. R. e kap përdore viktimën duke e mbajtur, e pandehura A. P. e godet disa herë me shuplakë viktimën e tri herë me gjunjë në pjesë abdominale, e të gjitha këto veprime përcillen me videoincizim dhe të qeshura nga tri të pandehurat.
Me këto veprime ekziston dyshimi i bazuar mirë se të pandehurat kanë përmbushur elementet e veprës penale të përshkruar si më lart.
Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës i ka propozuar gjykatës që të pandehurat të shpallën fajtore dhe të dënohen sipas ligjit për veprën penale e cila u vihet në barrë. Gjithashtu, në Departamentin e Krimeve të Rënda në këtë prokurori janë duke u ndërmarrë veprime hetimore për procesin e strehimores për veprat penale nga kapitulli i korrupsionit.





# Inspektohen punimet për ndërtimin e lagjes së re për familjet në nevojë në Podujevë

**Podujevë, 4 maj** - Drejtoresha e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Adelina Stublla, ka përcjellë nga afër punimet që po zhvillohen në ndërtimin e lagjes së re nga fondacioni "Shqiptarët për shqiptarët" për familjet me gjendje jo të mirë ekonomike në komunën e Podujevës.
Në këtë lagje po ndërtohen 22 shtëpi të banimit. Gjatë kësaj kohe po punohet në infrastrukturën nëntokësore dhe së shpejti do të bëhet invertarizimi i brendshëm i shtëpive dhe do të bëhet ndërtimi i infrastrukturës rrugore e cila do ta lehtësojë qasjen në këtë lagje.
Drejtoresha Stublla u nda e kënaqur me dinamikën dhe cilësinë e punimeve. Ajo u shpreh se së shpejti do të jenë në dispozicion shtëpitë e reja të banimit, të cilat janë të dedikuara për familjet me gjendje të rënduar ekonomike dhe që kanë probleme me çështjen e banimit.

## Vendoset gurthemeli i shkollës së re në Veternik

**Prishtinë, 4 maj** - Të enjten është vendosur gurthemeli i shkollës në Veternik.
Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka thënë se nxënësit e kësaj zone do të kenë mundësi ta vazhdojnë mësimin afër vendbanimit të tyre, me kushte të dinjitetshme, dhe jo me klasa të stërmbushura. "Shkolla do të ketë kapacitet për 1 080 nxënës, duke ofruar shkollim nga niveli parashkollor deri te klasa 9. Ndërtimi i shkollës do të bëhet me modalitetin publiko-privat dhe do të ketë sipërfaqe prej 6,726m². Shkolla pritet t'i hapë dyert brenda dy vjetëve", ka thënë kryetari Rama.



# Veprimtari Sali Bislimi ftohet në drekë në parlamentin zviceran, diskutohet për Kosovën dhe Specialen

**Bern, 4 maj** - Veprimtari Sali Bislimi, njëherësh drejtor i organizatës joqeveritare "Zëri Perëndimor i Kosovës", i cili jeton dhe vepron në Zvicër, ka takuar të enjten në Bërn nënkryetarin e Partisë PVL të Zvicrës. Temë diskutimi ishin raportet në mes të Kosovës dhe Zvicrës. "Pata nderin të jem i ftuar në drekë në parlamentin zviceran nga nënkryetari i Partisë PVL të Zvicrës, Michel Matter. Me parlamentarin, mikun tim Michel, në mënyrë shumë vëllazërore biseduam për të gjitha çështjet që lidhen mes Zvicrës dhe Kosovës, të komunitetit tonë këtu dhe integrimin. Zvicra i ka dyert shumë herë të mbyllura, por kur të hapen aty njeriu gjen ngrohtësinë, mirëqenien dhe respektin që janë të lidhura me lirinë dhe demokracinë", ka shkruar Bislimi në "Facebook".

Ai ka treguar se me Michelin temë e veçantë ishte edhe Kosova. "Historikun për Kosovën ia detajova në mënyrë të veçantë, shqetësimet tona, luftën tonë për liri, demokracinë fragjile, ndërtimin e shtetit, shtetit të së drejtës. Kosova ka betejën e saj për integrime në demokracinë perëndimore. Ajo nuk është pjesë luftërave të huaja dhe ka vetëm një objektiv - integrimin euro-atlantik të vendit dhe paqen e shumëdëshiruar në rajon", ka njoftuar Bislimi.



Temë diskutimi me parlamentarin zviceran ishte edhe Gjykata Speciale. "Gjykata politike e Hagës është edhe një sfidë tjetër për popullin e Kosovës. Të jesh në mbrojtje të presidentit Thaçi është mbrojtje e republikës sonë. Ai është i agresuari dhe jo agresori. Zvicra do të ishte mirë të luajë një rol pozitiv në këtë drejtim. Shqiptari i lindur në Kosovë dhe shqiptari i lindur nga familja shqiptare në Zvicër - cilat janë sot raportet, më pyeti. Ne jemi në tokën tonë, jemi mbrojtës të qytetërimit evropian të mbrojtur nga Gjergj Kastrioti, kryehero dhe nëna jonë Terezë për humanizimin ndaj qenies njerëzore. Ne si çdoherë në histori do t'i mbrojmë tokën tonë, kulturën shqiptare, besën, traditën, dhe t'i vijmë si vlerë e shtuar mozaikut evropian. Nga sot Kosova ka edhe një mik e ky është Michel Matter!", ka shkruar Bislimi.

# Certifikohet rezultati për Kuvendin Komunal në Leposaviq, tri ulëse mbesin të zbrazëta




**Leposaviq, 4 maj** - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka certifikuar rezultatet për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin Komunal të Leposaviqit. Megjithatë, kuvendi nuk është i plotë, pasi është miratuar rezultati vetëm për 16 asamblistë, ndërsa ka gjithsej 19 ulëse shkaku i mungesës së votave për kandidatët që kanë garuar për asamble nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje. Sipas rezultatit, Lëvizjes Vetëvendosje i takojnë 15 ulëse, por vetëm 12 kandidatë të saj kanë marrë vota, rrjedhimisht KQZ-ja ka vendosur që LV-ja të ketë vetëm 12 këshilltarë komunalë.

Partia Demokratike e Kosovës dhe Partia e Serbëve të Kosovës kanë marrë nga dy ulëse secila.

Kryetari i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, ka thënë se ka ardhur rekomandimi nga Sekretariati që rezultati të certifikohet pasi vetëm kështu i hapet rrugë krijimit të institucioneve lokale në Leposaviq. "Lëvizja Vetëvendosje 76.1 për qind, 15 ulëse të fituara. Partia Demokratike e Kosovës, 19.2 për qind, dy ulëse të fituara, Partia e Serbëve të Kosovës, 4.6 për qind, dy ulëse të fituara. Në listën e kandidatëve Lëvizja Vetëvendosje i ka 12 kandidatë të cilët kanë marrë vota. Partia Demokratike i ka dy kandidatë që kanë marrë vota dhe Partia e Serbëve të Kosovës dy kandidatë që kanë marrë vota", ka thënë Radoniqi.

Përfaqësuesi i Lëvizjes Vetëvendosje në KQZ, Sami Kurteshi, ka thënë se interpretimi i sekretariatit është i kundërligjshëm. Pas hedhjes në votim, tetë anëtarë të KQZ-së votuan për, dy anëtarët që përfaqësojnë LV-në votuan kundër, ndërsa përfaqësuesja e Listës Serbe abstenoi. Me këtë rast është certifikuar edhe rezultati për këto zgjedhje.

## Njohësi i çështjeve të emergjencave thotë se zjarrfikësit janë harruar nga shteti

**Prishtinë, 4 maj** - Të enjten është shënuar 4 Maji - Dita Ndërkombëtare e Zjarrfikësve Shpëtues. Tahir Ahmeti, njohës i çështjeve të emergjencave, njëherësh drejtor ekzekutiv i Qendrës Kërkimore për Politika të Sigurisë (SPRC), ka theksuar se zjarrfikësit e Kosovës janë të harruar nga shteti. "Edhe pse do të duhej të ishte ditë feste, te zjarrfikësit e Kosovës sot vërehet qartë zhgënjimi i pafund i tyre, duke filluar nga siguria e tyre në punë, mosdefinimi i statusit juridik, pagat, kushtet e mjerueshme të punës, injorimi i vazhdueshëm nga institucionet e vendit dhe një mori tjetër e problemeve që rëndojnë mbi këtë kategori të të punësuarve", ka shkruar Tahiri në "Facebook". Ai ka thënë se qeveria do të duhej të reflektojë mbi këtë institucion të rëndësishëm të sigurisë. "Ka qenë dhe është detyrim i të gjitha qeverive, që t'i përmirësojë kushtet e këtij shërbimi, në mënyrë që ata ta kryejnë sa më mirë punën e vet në shërbim të sigurisë së qytetarëve", ka shkruar Tahiri.



# Bosnjë-Hercegovina shet në Kosovë, nuk blen prej saj



PRISHTINË, 4 MAJ - Prodhimet me origjinë shtazore të prodhuara në Kosovë nuk arrijnë të depërtojnë në tregun e Bosnjë-Hercegovinës, ndërsa produktet e tilla të këtij shteti janë të pranishme në dyqanet e Kosovës, edhe përkundër faktit se të dyja vendet janë pjesë e një marrëveshjeje të njohur si CEFTA, e cila ka për qëllim lehtësimin e këmbimeve tregtare në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Disa kompani prodhuese në Kosovë kanë kërkuar tashmë nga institucionet e vendit të bëjnë trysni tek autoritetet e Bosnjë-Hercegovinës për t'ua lejuar hyrjen në tregun e tyre. Një nga to është edhe "Apetit", që merret me prodhimin dhe përpunimin e produkteve të mishit.

Sami Ferizi, aksionar në këtë kompani, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se kompania ka kapacitete të mjaftueshme për eksport. Prodhimet e saj, thotë ai, janë të pranishme në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, si në Maqedoni të Veriut, Shqipëri dhe Mal të Zi.

Bosnjë-Hercegovina dhe Serbia janë shtetet e vetme në rajon që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, të shpallur në vitin 2008 dhe, si të tilla, nuk e njohin as certifikatën veterinare të Kosovës.

Certifikata veterinare është dokument që e konfirmon sigurinë e ngarkesave veterinare. Në këtë certifikatë prodhuesi është i obliguar ta shkruajë edhe emrin e origjinës së produktit - në këtë rast Republika e Kosovës.

Ferizi tregon se ka dërguar disa kërkesa zyrtare në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës në Kosovë (AUV), që kjo e fundit të kërkojë nga autoritetet e Bosnjës që t'i lejojnë mallrat "Made in Kosova" në tregun e saj. Kërkesën e fundit thotë se e ka bërë para rreth dy muajsh.

"Bosnjë-Hercegovina nuk është e interesuar të bashkëpunojë me ne. Ajo sjell sasi të mëdha të produkteve të mishit në tregun tonë, kurse ne nuk eksportojmë. Çfarë kanë ata më shumë se ne, që ne të mos kemi mundësi t'i sheshim produktet tona atje?", thotë Ferizi.

Drejtori ekzekutiv i AUV-it, Flamur Kadriu, konfirmon për "Radion Evropa e Lirë" se në fund të vitit të kaluar ka kërkuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës në Bosnjë-Hercegovinë që ta lejojë depërtimin e prodhimeve kosovare me origjinë shtazore. Në mars, shton ai, shkresë zyrtare për të njëjtin qëllim u është dërguar edhe zyrtarëve të qeverisë të këtij shteti.

Ramadan Mema, nga Shoqata e Përpunuesve të Qumështit në Kosovë, thotë se me bllokimin e produkteve me origjinë shtazore nga Kosova, Bosnjë-Hercegovina po shkel Marrëveshjen CEFTA. Ai i bën thirrje Qeverisë së Kosovës t'i mbrojë prodhuesit vendorë dhe të ndërmarrë masa për depërtimin e produkteve të tyre në Bosnjë.

CEFTA është një marrëveshje ndërkombëtare e krijuar nga Bashkimi Evropian. Në këtë mekanizëm, përveç Kosovës, bëjnë pjesë: Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Serbia, Mali i Zi, Bosnjë-Hercegovina dhe Moldavia.

Nga viti 2018 deri në prill të vitit 2023 Kosova ka importuar nga Bosnjë-Hercegovina produkte në vlerë prej rreth 240 milionë eurosh, tregojnë të dhënat e Doganës së Kosovës. Përveç produkteve të qumështit dhe mishit, nga Bosnja në Kosovë hyjnë edhe pije, alkool, produkte të drurit, qeramikës, qelqit, lodra etj.

Gjatë së njëjtës periudhë Kosova ka eksportuar në Bosnjë-Hercegovinë produkte në vlerë prej rreth 48 milionë eurosh. Në mesin e tyre kryesisht bëjnë pjesë: produktet e drurit, plastikës, pëlhura dhe veshje të punuara me dorë.

# Oda Amerikane: Rregullimi i çmimit të barnave, një hap përpara drejt shërbimeve cilësore shëndetësore

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 4 MAJ - Rregullimi i çmimit të barnave në Kosovë është një hap përpara drejt shërbimeve cilësore shëndetësore, me theks në barazi. Si avokues kryesor për promovimin e sektorit privat dhe rritjes ekonomike në Kosovë, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë kupton rëndësinë kritike të një sistemi funksional shëndetësor në vend. "Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë gjithashtu vlerëson përpjekjet e qeverisë për përcaktimin e parimeve të Çmimeve Referenciale Ndërkombëtare (IRP) dhe e mbështet këtë rregullore si një ndër mënyrat për të siguruar qëndrueshmëri dhe qasje të vazhdueshme në barna për pacientët kosovarë. IRP duhet të zbatohet në përpikëri, por nuk duhet të mbetet i vetmi mekanizëm për përmirësimin e qasjes në barna për pacientët. Duhet të merren në konsideratë edhe mekanizma të tjerë si negociatat e drejtpërdrejta me prodhuesit inovatorë dhe marrëveshjet e hyrjes së menaxhuar (MEA) si pjesë e procesit të rimbursimit", është thënë në reagimin e Odës Amerikane. Sipas saj, qasja në shërbime të përballueshme të kujdesit shëndetësor dhe me cilësi të lartë është thelbësore për zhvillimin ekonomik të Kosovës, pasi rrit produktivitetin, aftësitë e fuqisë punëtore dhe mirëqenien e përgjithshme të popullatës, prandaj rregullimi i çmimeve të barnave është një komponent kritik i sigurimit të qasjes së përballueshme dhe të barabartë në kujdesin shëndetësor në Kosovë.

"Vendosja e kontrolleve të çmimeve ndihmon në adresimin e çështjes së kostos së lartë të barnave, duke promovuar çmime fer dhe të përballueshme për barnat esenciale, për të siguruar që të gjithë individët të kenë qasje në barnat që u shpëtojnë jetën pavarësisht nivelit të të ardhurave të tyre", thuhet në reagimin e kësaj ode.

Në këtë drejtim, Oda Amerikane mirëpret dhe ofron të gjithë mbështetjen tonë për miratimin dhe zbatimin e shpejtë të Ligjit për Çmimin e Barnave në Kuvendin e Kosovës. "Oda Amerikane beson se rregullimi i çmimit të barnave luan një rol vendimtar në promovimin e qasjes në barna, stimulimin e inovacionit dhe promovimin e konkurrencës në tregun farmaceutik dhe rritjen e efikasitetit të përgjithshëm të sistemit të kujdesit shëndetësor. Kjo bazë rregullative do të mundësojë që çmimet e barnave të jenë të arsyeshme, fer dhe transparente duke mbrojtur edhe interesat e kompanive farmaceutike, që përbëjnë një industri kyçe për ekonominë e Kosovës", thuhet më tutje në reagim.

Në fund, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë e konsideron rregullimin e çmimit të barnave si një ndërhyrje me ndikim për ta promovuar qasjen në barna esenciale, për t'i përmirësuar rezultatet e kujdesit shëndetësor si dhe për ta avancuar zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Kosovës.

## Arta Hoxha zgjedhet anëtare joekzekutive e Bordit të BQK-së



PRISHTINË, 4 MAJ - Kuvendi i Kosovës, në raundin e dytë, ka zgjedhur Arta Hoxhën anëtare joekzekutive të Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK). Në këtë votim të fshehtë morën pjesë 90 deputetë, 47 vota mori Arta Hoxha, 35 Valdrin Kasumaj dhe 8 vota ishin të pavlefshme. Në raundin e parë më i votuari ishte Valdrin Kasumaj me gjithsej 46 vota, i pasuar nga Arta Hoxha me 37 vota, Afrim Atashi 1 votë, Enver Bajçinca 1 dhe Florim Peci asnjë votë.

# Qytetarët e Kosovës janë të frustruar me Gjykatën Speciale, kanë frikë se mund të rishkruhet historia e luftës për liri, thuhet në analizën ndërkombëtare




Gjykimi në Hagë shihet si një proces kundër UÇK-së në tërësi dhe luftës së shqiptarëve. Kosovarët kanë frikë se Gjykata mund rishkruaj historinë e luftës së UCK-së dhe të barazoj krimet. Gjykata ndjek vetëm shqiptarë. Për shumicën e shqiptarëve, krerët e UCK-se që janë akuzuar në Hage mbrojtën me guxim vendin kundër spastrimit etnik të Serbisë së MilloshevIçit. Akuzat e Dick Martyt për trafikim organesh nuk duken askund.
Këto janë disa nga konstatimet e analizës rreth Gjykatës Speciale në Hagë, e publikuar më 2 maj 2023, në faqen e Këshillit Evropian për Marrëdhënie Ndërkombëtare (ECRF), një institut me renome botërore, me seli në kryeqytetet e shteteve kryesore të Bashkimit Evropian.
"Krijimi i gjykatës ishte gjithashtu i diskutueshëm. Ideja për Dhomat e Specializuara u vu në lëvizje pasi politikani zviceran Dick Marty shkroi një raport për Këshillin e Evropës në vitin 2010, në të cilin ai pretendonte se udhëheqja e UÇK-së kishte kryer krime lufte, përfshirë trafikimin e organeve. Akuzat e Martit, veçanërisht ato për trafik organesh, fituan vëmendjen e medias mbarëbotërore dhe u përhapën gjerësisht nëpër kanalet e lajmeve të Rusisë dhe Serbisë. Por tani që gjykata është ngritur dhe funksionon, trafikimi i organeve nuk është përmendur në akuza apo në gjyq, duke bërë që shumë shqiptarë të Kosovës të vënë në dyshim qëllimet e gjykatës", thuhet në këtë shkrim analitik.
Në shkrim rikujtohet se një ditë para fillimit të gjyqit ndaj ish-presidenti Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, mijëra shqiptarë të Kosovës dolën në rrugët e kryeqytetit, Prishtinë, duke mbajtur pankarta ku shkruhej "Kosova nuk mund të rishkruhet", "Liria ka emër - UÇK" ose "Evropë, a je duke bërë shaka?", dhe bën thirrje për drejtësi dhe jo politikë.
"Mijëra kosovarë kanë protestuar dhe kanë frike se Gjykata Speciale mund te shkaktoj dykuptimësi për të vërtetën dhe të barazoj përgjegjësinë e Serbisë dhe Kosovës gjatë luftës", thuhet tutje.
Në vitin 2015, Kuvendi i Republikës së Kosovës themeloi Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare për të gjykuar krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit të kryera gjatë dhe pas konfliktit. Por gjykata ka thelluar polemikën rreth ndjekjes penale të krimeve të luftës në Kosovë. Gjykata ka një mandat të kufizuar dhe deri më tani ka ndjekur penalisht vetëm shqiptarët e Kosovës.
Në analizë thuhet se përpjekjet e vetë Serbisë për të ndjekur penalisht krimet e luftës që nga viti 2017 kanë qenë të kufizuara. Juridiksioni i gjykatës thotë qartë se ajo ndjek penalisht individët për përgjegjësinë e tyre penale, por në Kosovë gjykimi kundër liderëve të UÇK-së shihet kryesisht si një proces kundër UÇK-së në tërësi dhe rezistencës shqiptare në luftë.
"Deri më tash kjo Gjykatë është duke shkaktuar kundërthënie dhe mund të komplikojë përpjekjet për pajtim mes Kosovës dhe Serbisë.", potencohet në raport.
Për shumicën e shqiptarëve të Kosovës, ish-presidenti Thaçi dhe bashkëluftëtarët e tij që janë në gjyq e mbrojtën me guxim vendin kundër fushatës brutale të spastrimit etnik të Serbisë së Sllobodan MilloshevIçit, gjatë së cilës mbi 800,000 civilë shqiptarë u dëbuan me forcë nga shtëpitë e tyre dhe mijëra u vranë dhe u përdhunuan. Nga 13,517 personat e vrarë në konflikt, 10,415 ishin shqiptarë, 2,197 serbë dhe 528 romë dhe komunitete të tjera. Askush nuk e mohon se pjesëtarë të veçantë të UÇK-së mund të kenë kryer krime apo nevojën për t'u përballur me drejtësinë. Në dhjetor, Dhomat e Specializuara dënuan një ish-komandant të UÇK-së me 26 vjet burgim për kryerjen e krimeve të luftës. Kosovarët e kuptojnë këtë vendim dhe pranojnë se krime të tilla nuk mund dhe nuk duhet të mbeten pa u ndëshkuar.
Megjithatë, ne raport thuhet se ata mbeten të frustruar që gjykata ndjek penalisht vetëm shqiptarët e Kosovës, ndërsa mijëra prej tyre ende presin të shohin autorët e tyre të ndiqen penalisht për krime lufte.
"Në vitet e fundit, Serbia dhe Kosova kanë lëvizur edhe më larg nga pajtimi, pjesërisht për shkak se qeveria serbe refuzon të pranojë rolin brutal që Serbia luajti në luftë. Perëndimi ka qenë në gjendje ta detyrojë Kosovën të ballafaqohet me të kaluarën e saj, por nuk ia ka dalë ta detyrojë Serbinë të bëjë të njëjtën gjë. Kjo fatkeqësisht mund t'i shërbejë retorikës revizioniste të qeverisë serbe për luftën. Dhe rrezikon të rrënjos më tej ndjenjat e armiqësisë midis dy vendeve dhe të parandalojë pajtimin", thuhet tutje në analizën e botuar në ECRF, nga autorja kosovare, Tefta Kelmendi, e cila është koordinatore në këtë institut prestigjioz.
Themelimi i Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe gjykimi zbulojnë sfidat e drejtësisë tranzicionale. Gjykata duhet të zgjasë mandatin e saj për të përfshirë krimet e kryera nga serbët në konflikt, gjë që do të krijonte besim në gjykatë dhe do të ndihmonte të dyja palët të përballen me të kaluarën. Përndryshe, duhet të fokusohet në arritjen e një vendimi të shpejtë për t'i lejuar shqiptarët të mbyllin këtë kapitull të historisë së tyre dhe të fillojnë të imagjinojnë paqen dhe pajtimin me Serbinë.
"Ndërkohë, Perëndimi duhet të përdorë levën e tij me Serbinë për të bërë presion mbi udhëheqjen për të ndjekur penalisht kriminelët e luftës të rangut të lartë në Serbi. Në fund të fundit, pajtimi mes dy vendeve kërkon që të dyja palët të njohin përgjegjësinë e tyre për krimet e luftës të kryera në Kosovë. Perëndimi duhet ta mbështesë këtë proces në një mënyrë që të mos rrezikojë t'i shërbejë revizionizmit të luftës nga qeveria e Serbisë, theksohet në këtë raport. **Sadik ZEQIRI**




Sport


Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

# Ballkani barazon ndaj Prishtinës, përfiton Drita

Java e 32-të në Superligë është mbyllur me dy ndeshjet e zhvilluara të enjten. Drita e ka mposhtur Llapin në Podujevë, ndërsa Ballkani ka mbetur baras me Prishtinën




EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 4 MAJ - Superliga e futbollit në Kosovë është duke u bërë mjaft interesante në përfundim të edicionit 2022/23. Dallimi mes dy skuadrave të para në tabelë, Dritës dhe Ballkanit, është katër pikë. Skuadra e Dritës është duke ecur sigurt në rrugën për titull të kampiones në Superligën e Kosovës në futboll, pasi të enjten e ka mposhtur Llapin në stadiumin "Zahir Pajaziti" me rezultat 0-2. "Jam i lumtur me fitore. Nuk jam i lumtur me 25 minutat e parë. Në zhveshtore folëm për këtë, dolëm, shënuam dy gola dhe fituam. Edhe djemtë e dinin se çka duhet të bënin. I falënderoj shumë tifozët 'Intelektualët' për përkrahjen. Kemi tifozë fantastikë. Nuk ka presion. Më e vështira nuk është të arrish vendin e parë, është të qëndrosh aty. Jam i lumtur me lojtarët. Të dielën do të kemi lojë të madhe", ka thënë pas ndeshjes trajneri i Dritës, Akis Vavalis.
Festim Alidema shpërdoroi në pjesën e parë mundësinë më të mirë për t'i kaluar vendasit në epërsi, pasi e humbi penalltinë. Gjilanasit në pjesën e dytë ishin më të rrezikshëm dhe arritën ta krijojnë epërsinë në minutën e 59, kur Blend Baftiu realizoi për rezultatin final 0-1. Katër minuta pa përfunduar ndeshja, Drita mbeti me një lojtar më pak, por kjo nuk i pengoi që në shtesë ta realizojë edhe golin e dytë nëpërmjet Ovoukas. "Kishim mungesa dhe ra loja. Drita nuk bëri asgjë, por ne ia mundësuam fitoren, pasi nuk shënuam nga penalltia. Lojtarët kryesorë munguan. Kjo ishte pika jonë e dobët. Ne nuk ishim efikas në finalizim. Kurtaj nuk i bëri krosimet si duhet. Kur nuk arrin të shënosh, është vështirë ta fitosh ndeshjen. Drita u mbrojt me të gjitha forcat që të mos barazohet rezultati", ka deklaruar pas ndeshjes trajneri i Llapit, Tahir Batatina.
